

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Menaxhment Financiar
Financial Management
(zgjidhjet)**

P7

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test

Data: 28.01.2017

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	25	
2. Problemi 2	25	
3. Problemi 3	25	
4. Problemi 4	25	
Total	100	

Problemi 1

(a) Kompania ABC SHPK dëshiron të kalkuloj koston mesatare të ponderuar të kapitalit. Informacionet në dispozicion janë:

Numri i aksioneve të zakonshme	€20 milion
Vlera kontabël e obligacionit të konvertueshëm, me interes prej 7%	29 milion
Vlera kontabël e huas bankare me interes prej 8%	2 milion
Çmimi i tregut i aksioneve të zakonshme	€5.50 për aksion
Vlera e tregut e obligacioneve të konvert.	€107.11 për çdo €100 të vlerës nominale të obligacioneve
Koeficienti Beta i aksioneve të ABC SHPK	1.2
Norma e kthimit pa rrezik	4.7%
Premia për rrezikun e ndërmarrë ($R_m - R_f$)	6.5%
Norma e tatimit në fitim	30%

Norma mesatare e pritur e rritjes së çmimit të aksioneve është 6% në vit. Obligacionet e konvertueshme mund të riblehen pas 8 viteve me vlerën e tyre nominale, ose mund të konvertohen pas 6 viteve në 15 aksione të zakonshme të kompanisë ABC SHPK për çdo €100 të vlerës nominale të obligacioneve.

Kërkohet:

(i) Kalkuloni koston mesatare të ponderuar të kapitalit (KMPK/WACC) sipas vlerës së tregut për kompaninë ABC SHPK.

(14 pikë)

(ii) Diskutoni rrethanat në bazë të së cilave kosto mesatare e ponderuar e kapitalit (KMPK/WACC) mund të shfrytëzohet gjatë vlerësimit të projekteve kapitale/investive.

(6 pikë)

(b) Në mbledhjen e fundit të drejtorëve të kompanisë ABC SH.A., një drejtor jo-ekzekutiv i sugjeroi komisionit për kompensime që të marr parasysh skemën aktuale të opsioneve në aksione, pasi që drejtorët ekzekutiv mund të shpërblehen nga kjo skemë edhe në rastet kur kompania nuk performon mirë. Një drejtor tjetër jo-ekzekutiv nuk u pajtua duke theksuar se edhe në rastet kur drejtorët veprojnë në atë mënyrë që redukton problemin e agjencisë, ata nuk mund të shpërblehen nga skema e opsioneve në aksione në rastet kur çmimi i aksioneve është në rënie.

Kërkohet:

Shpjegoni natyrën e problemit të agjencisë si dhe diskutoni shfrytëzimin e skemës së opsioneve në aksione si mënyrë për reduktimin e problemit të agjencisë për një kompani të listuar në bursë, si rasti i kompanisë ABC SH.A.

(5 pikë)

(Totali = 25 pikë)

Problemi 2 - Zgjidhja

(a)

(i) Kalkulimi i kostos mesatare të ponderuar të kapitalit (KMPK/WACC)

Kosto e ekuitetit (aksioneve të zakonshme)

Kosto e ekuitetit sipas modelit të vlerësimit të asetëve kapitale (CAPM) = $4.7 + (1.2 \times 6.5) = 12.5\%$

Kosto e obligacioneve të konvertueshme

Pagesa vjetore e interesit pas-tatimit = $7 \times (1 - 0.3) = €4.90$ për obligacion

Çmimi i tregut i aksioneve pas 6 viteve = $5.50 \times 1.06^6 = €7.80$

Vlera e konvertimit = $7.80 \times 15 = €117.00$ për obligacion

Konvertimi duket të jetë i mundshëm pasi që vlera e konvertimit është më e lartë sesa vlera nominale e obligacioneve.

Rrjedhat e parave në të ardhmen e cila duhen të skontojnë janë 6 pagesat e interesit pas tatimit dhe vlera e konvertimit e pranuar pas 6 viteve:

Viti	Rrjedha e parash	€	10% Faktori	VT (€)	5% Faktori	PV (€)
0	vlera e tregut	(107.11)	1.000	(107.11)	1.000	(107.11)
1-6	interesi	4.9	4.355	21.34	5.076	24.87
6	konvertimi	117.00	0.564	66.00	0.746	87.28
				-----		-----
				(19.77)		5.04
				-----		-----

Duke shfrytëzuar interpolimin linear, kosto e obligacioneve pas tatimit është = $5 + [(5 \times 5.04) / (5.04 + 19.77)] = 6.0\%$.

Mund ta konfirmojmë se konvertimi është i mundshëm pasi që çmimi aktual i tregut €107.11 duke parë se çmimi dysheme i obligacioneve të konvertueshme me një kosto të obligacioneve pas tatimit prej 6% është €93.13 ($4.9 \times 6.210 + 100 \times 0.627$).

Kosto e huas bankare

Norma e interesit pas tatimit është = $8 \times (1 - 0.3) = 5.6\%$

Vlerat e tregut

Vlera e tregut e ekuitetit = $20m \times 5.50 = €110$ milion

Vlera e tregut e obligacioneve të konvertueshme = $29m \times 107.11/100 = €31.06$ milion

Vlera kontabël e huas bankare = €2m

Vlera totale e tregut = $110 + 31.06 + 2 = €143.06$ milion

KMPK (WACC) = $[(12.5 \times 110) + (6.0 \times 31.06) + (5.6 \times 2)] / 143.06 = 11.0\%$

(ii)

Kosto mesatare e ponderuar e kapitalit (KMPK/WACC) mund të shfrytëzohet si normë skontuese gjatë vlerësimit të projekteve kapitale vetëm nëse rreziqet e projektit investues janë të ngjashme me rreziqet e kompanisë e cila është duke planifikuar të ndërmarr investimit. Në këtë rast KMPK/WACC do të reflektoj këto rreziqe do të përfaqësoj kthimin mesatar të kërkuar si kompensim për këto rreziqe. Kjo nënkupton se KMPK/WACC mund të shfrytëzohet për të vlerësuar zgjerimin e biznesit ekzistues. Nëse rreziku biznesor i projektit investues është i ndryshëm nga rreziku ekzistues i operacioneve të kompanisë, atëherë duhet të kalkulohet norma skontuese specifike e cila i reflekton këto rreziqe. Modeli CAPM mund të shfrytëzohet për të arritur deri te një normë e tillë.

KMPK mund të përdor në një vlerësim të projektit kapital nëse rreziku financiar i projektit të propozuar është i ngjashëm me rrezikun financiar të operacioneve ekzistuese të kompanisë. Kjo nënkupton se financimi i projektit duhet të bëhet në atë mënyrë që të ruhet struktura ekzistuese e kapitalit të kompanisë. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë duhet aplikuar një metodë tjetër të vlerësimit të projekteve kapitale të quajtur vlera e korrigjuar e tanishme (APV). Në mënyrë alternative, mund të korrigjohet CAPM për të reflektuar rrezikun financiar të financimit të projektit.

(b)

Qëllimi kryesor i menaxhmentit financiar të një kompanie zakonisht është maksimizimi i vlerës së pasurisë së aksionarëve të saj. Në praktik, menaxherët e kompanisë të cilët veprojnë si agjent të principalëve (aksionarëve) mund të operojnë në atë mënyrë e cila nuk e maksimizon vlerën e pasurisë së aksionarëve. Dështimi i menaxherëve në maksimizimin e vlerës së aksionarëve njihet si problem i agjencisë.

Pasuria e aksionarëve rritet nëpërmjet pagesës së dividendës dhe nëpërmjet ngritjes së çmimit të aksioneve në treg. Pasi që çmimet e aksioneve reflektojnë vlerën e caktuar blerësit mbi të drejtën për të pranuar dividendët, atëherë analiza e ndryshimeve në pasurinë e aksionarëve më shumë përqendrohet në ndryshimet në çmimet e aksioneve. Qëllimi i maksimizimit të çmimit të aksioneve zakonisht përdoret si objektivi i përshtatshëm për maksimizimin e pasurisë së aksionarëve.

Problemi i agjencisë paraqitet atëherë kur objektivat e menaxherëve dallojnë nga ato të aksionarëve: për shkak se në kompanitë moderne ekziston ndarja e pronësisë nga menaxhmenti; dhe pasi që ekziston asimetria e informatave ndërmjet aksionarëve dhe menaxherëve fakt ky që i pengon aksionarët që të jenë në dijeni për secilin vendim menaxherial.

Një mënyrë për ti inkurajuar menaxherët që të veprojnë në atë mënyrë e cila e shton vlerën e pasurisë së aksionarëve është që ti ofrohet atyre opsione në aksione. Këto paraqesin të drejta për të blerë aksione në një datë të ardhme me një çmim i cili është i fiksuar në datën kur këto opsione i janë dhënë menaxherëve. Opsionet në aksione do ti motivojnë menaxherët që të marrin vendime të tilla të cilat ndikojnë në rritjen e çmimit të aksioneve (p.sh., investimet me NVT pozitive), pasi që kjo do të rrisë shpërblimet që ata do ti pranojnë nga opsionet në aksione. Sa më i lartë çmimi i aksioneve në treg në kohën kur opsionet maturojnë (këmbehen në aksione), aq më i madh fitimi kapital që mund të realizojnë menaxherët të cilët i posedojnë këto opsione. Prandaj mund të thuhet se opsionet në aksione ndikojnë në zvogëlimin e dallimit ndërmjet objektiveve të aksionarëve dhe menaxherëve.

Sidoqoftë, është e mundur që menaxherët mund të shpërblehen për performacë të dobët nëse çmimet e aksioneve pësojnë rritje vetvetiu. Gjithashtu është e mundur që menaxherët të mos shpërblehen për performacë të mirë nëse çmimet e aksioneve pësojnë rritje vetvetiu.

Problemi 2

ABC SHPK është në negociata me një kompani Franceze në lidhje me një investim të ri kapital për blerje të pajisjeve të reja të prodhimit. Pajisjet do të përdoren vetëm për prodhimin e dritareve të pllantikës. Gjithashtu, përveç kostos së blerjes së pajisjeve, ABC duhet të paguaj transportin dhe komisionet shtesë që në total arrin shumën €400,000. Pritet që kjo pajisje e prodhimit do të ketë jetëgjatësi 3 vjeqare. Menaxheri i shitjes të ABC planifikon që kompania mund të shesë rreth 400,000 dritare në vit, pa pasur ndikim në shitjet e produkteve tjera.

Përmbledhje e planit biznesor të këtij investimi:

2. Kjo linjë e prodhimit do të funksionoj 50 orë në javë (50 javë në vit) dhe mund të prodhoj 20 dritare në orë.
3. Pritet që 5% e prodhimit do të shndërrohet në mbeturina me një kosto prej €10 euro për dritare.
4. Mirëmbajtja pritët të jetë €600,000 fikse/vit, duke filluar nga viti i 2-të.
5. Kosto e punës në vitin e parë pritët të jetë €10 për dritare të prodhuar. Një rritje prej 1€ për dritare pritët të jetë në secilin vit të mëtuqjeshëm.
6. Materialet pritët të kenë një kosto prej €120/dritare. Kjo kosto pritët të rritet 10% në vit në vitet e mëtuqjeshme.
7. Secila dritare do të shitet në lartësi prej €200 në vitin 1, me një rritje vjetore prej 5% në vitet e mëtuqjeshme.
8. Kostot variabile të linjës së prodhimit do të jenë €100 për orë, të cilat do të mbesin statike përgjatë tri viteve të ardhshme.
9. Nëse ABC vendos të blejë këtë linjë të prodhimit, pagesa e saj duhet të bëhet në avanc.

Kosto e kapitalit para tatimit për ABC është 8%.

Kërkohet:

(i) Kalkuloni çmimin që do të duhet të paguhej për këtë teknologji të propozuar (injoroni tatimet).

(13 pikë)

(ii) Diskutoni katër faktorët strategjik që ABC duhet ti merr në konsideratë gjatë marrjes së vendimit final për pranimin e investimit apo jo.

(12 pikë)

(Totali = 25 pikë)

Zgjidhja e Problemi 2

(i)

Çmimi maksimal i pranueshëm për blerje të linjës së prodhimit është €5,571,932, e llogaritur si në vijim:

	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Transporti	-400,000			
Shitje		9,500,000	9,975,000	10,473,750
Kosto e mbeturinave		-25,000	-25,000	-25,000
Mirëmbajtja			-600,000	-600,000
Puna		-500,000	-550,000	-600,000
Materialet		-6,000,000	-6,600,000	-7,260,000
Vlera mbetëse				500,000
Energjia elektrike		-250,000	-250,000	-250,000
Rrjedha neto e parasë	-400,000	2,725,000	1,950,000	2,238,750
Faktori skontues	1	0.9259	0.8573	0.7938
Vlera e tanishme	-400,000	2,523,078	1,671,735	1,777,120
Vlera neto e tanishme				5,571,932

(ii)

Faktorët tjerë:

-Sa është i besueshëm teknikisht kjo teknologji e re e propozuar?

-Kush do të bëjë mirëmbajtjen e kësaj teknologjie dhe sa kohë do të merr ndërprerja e pajisjes gjatë kohës së mirëmbajtjes?

-Sa është financiarisht stabile kompania që Franceze që po shet këtë teknologji?

-A është e mundur të rritet jetëgjatësia e kësaj pajisje, dhe për sa kohë?

-Si do ti furnizojmë klientët me dritare pas periudhës 3-vjeqare?

-A mund të aftësohemi që të mirëmbajmë teknologjinë e propozuar.

-A ekziston ndonjë kufizim në kapacitetin e linjës së prodhimit nëse vendoset që të punohet me shiftë (turne) shtesë?

Problemi 3

Kompania ABC e cila merret me shitjen e pajisjeve sportive ka pasur një rritje të shitjeve në tri vitet e fundit. Bilanci i gjendjes dhe pasqyra e të ardhurave janë prezantuar në vijim:

	ABC	
	31.12.2006 dhe 31.12.2007	
	2006	2007
	€000s	€000s
Pasuritë afatgjata		
Patundshmëritë dhe pajisjet	700	1,300
Pasuritë tjera	40	140
	<hr/>	<hr/>
Totali i pasurive afatgjata	740	1,440
Pasuritë afatshkurta		
Stoqet e mallrave	240	720
Të arkëtueshmet tregtare	180	530
Paraja	500	0
	<hr/>	<hr/>
Totali i pasurive afatshkurtra	920	1,250
	<hr/>	<hr/>
Totali i pasurive	1,660	2,690
	<hr/>	<hr/>
Ekuiteti dhe detyrimet		
Ekuiteti		
Kapitali aksionar (@ €2 secila)	200	200
Rezervat tjera	470	1,170
	<hr/>	<hr/>
	670	1,370
Detyrimet afatgjata		
Huazimet	300	100
Detyrimet afatshkurta		
Të pagueshmet tregtare	280	420
Dividenda e pagueshme	100	150
Huazimet afatshkurtra	30	460
Huazimet afatgjata, pjesa afatshkurtër	280	190
	<hr/>	<hr/>
Totali i detyrimeve afatshkurtra	690	1,220
	<hr/>	<hr/>
Totali i ekuitetit dhe detyrimeve	1,660	2,690
	<hr/>	<hr/>

ABC

	01.01.2016 - 31.12.2006 & 01.01.2017 - 31.12.2017	2007
	2006	
	€000s	€000s
Të hyrat	4,700	6,700
KMSH	3,600	4,800
Fitimi bruto	1,100	1,900
Minus: Shpenzimet	780	1,150
Fitimi neto	320	750
Fitimi për aksion (FPA/EPS)	€3.20	€7.50
Dividenda e deklaruar për aksion	€1	€1.50

Pas shpalljes së rezultateve të kompanisë ABC për vitin 31.12.2017, vlera e tregut të aksioneve është rritur në €20/aksion.

Performanca financiare e kompanive të cilat operojnë në të njëjtën industri me atë të ABC është paraqitur në vijim:

Koeficientet e industrisë	2007
Raporti çmim/fitim	2 herë
Kthimi nga kapitali i angazhuar	20%
Mbulesa e dividendës	4 herë
Kthimi i dividendës	6%
Kthimi mbi fitimet	30%

Kërkohet:

(i) Vlerësoni menaxhimin e kapitalit qarkullues të ABC gjatë dy viteve të dhëna. (14 pikë)

(ii) Rishikoni performancën e ABC në raport me atë të industrisë nga perspektiva e një investitori, për vitin që përfundon më 31.12.2007.

(11 pikë)

(Totali = 25 pikë)

Zgjidhja e problemi 3

Raport

Për: Menaxhmentin

Nga: Kontabilisti

Date: 04.01.2008

Subjekti: Menaxhimi i kapitalit qarkullues

Hyrje

Qëllimi i këtij raporti është të rishikoj menaxhimin e kapitalit qarkullues të kompanisë ABC përgjatë dy viteve të fundit dhe të merr në konsideratë performancën e kompanisë nga perspektiva investuese.

Menaxhimi i kapitalit qarkullues

Me rritjen e kompanisë tuaj, ka pasur rritje të madhe në investim në kapital qarkullues. Kjo rrjedhë si pasojë e rritjes së qarkullimit dhe pjesërisht si rezultat i menaxhimit më pak efikas të kapitalit qarkullues. Cikli operativ i parasë i ABC është rritur nga 10 në 52 ditë, nga viti 2006 në vitin 2007. Detajet janë prezantuar në tabelën në vijim:

ABC Kalkulimi i ciklit operativ të parasë (ditët)	2006 Ditët	2007 Ditët
Ditën në stoke	24	55
Ditët në II/a	14	29
Ditët në II/p	-28	-32
Cikli operativ i parasë	10	52

Kjo rrjedhë kryesisht nga mbajtja e stokeve për më shumë se 31 ditë dhe klientëve i merr kohë mbi 15 ditë për të kryer obligimet e tyre. Përderisa rritja e biznesit do të nënkuptonte një rritje natyrale në kërkesat për kapital qarkullues, rritjet aktuale tregojnë një dëmtim të kontrollit kreditor dhe të kontrollit të stokeve.

Investimi i ABC në asete kapitale në lartësi prej €700,000 në vitin që përfundon më 31.12.2007 është financuar kryesisht nga kapitali qarkullues, pasi që balanca e parasë në lartësi prej €500,000 më 31.12.2006 është shfrytëzuar dhe zëvendësuar me rritjen e huazimeve afatshkurtra në lartësi prej €430,000. Kjo ka ndikuar që likuiditeti i kompanisë të rrezikohet. Tabela e mëposhtme demonstroi dëmtimin e koeficientit afatshkurtër dhe koeficientit të shpejtë përgjatë këtyre dy viteve:

ABC mbetet investim atraktiv në krahasim me standardet e industrisë. Tabela në vijim demonstroi që ABC tejkalon normat mesatare të industrisë në të gjithë indikatorët. I një rëndësie të veçantë për ABC është koeficienti çmim/fitim, i cili e tejkalon mesataren e industrisë me 0.7.

ABC Indikatorët e likuiditetit	2006	2007
Koeficienti aktual	1.33	1.02
Koeficienti i shpejtë	0.99	0.43

Konkluzion:

ABC duhet të përmirësoj menaxhimin e kapitalit qarkullues dhe të financoj rritjen e tij duke marrë hua afatgjatë. Nuk do të ketë vështirësi të emetoj aksione të reja, pra të financohet nëpërmjet ekuitetit, duke marrë për bazë që ABC operon mbi nivelet mesatare të industrisë së saj.

ABC		
Indikatorët e likuiditetit	2006	2007
Koeficienti aktual	1.33	1.02
Koeficienti i shpejtë	0.99	0.43

Krahasimi me industrinë	Industria	ABC
Çmim/fitim	2 herë	2.7 herë
Kthimi nga kapitali i angazhuar	20%	27.88%
Mbulesa e dividendës	4 herë	5 herë
Kthimi nga dividenda	6%	7.50%
Kthimi nga fitimi	30%	37.50%

Problemi 4

Sot është data 13 Gusht 2009. ABC, kompani Marokiene është duke planifikuar të blejë kompaninë konkurrenente CAB nga Maroko e cila përdorë valutën ZAR. Gjatë diskutimeve fillestare me kompaninë CAB, ata janë pajtuar për një blerjen e propozuar nga ABC.

Bilanci i gjendjes i projektuar i datës 30 shtator 2009, datë kjo e blerjes së planifikuar, është prezantuar si në vijim:

Bilanci i gjendjes i planifikuar më 30 shtator 2009

Pasuritë afatgjatë	ZAR 48
Pasuritë afatshkurtra	ZAR 24
Detyrimet afatgjata	-ZAR18
Detyrimet afatshkurtra	-ZAR12
Pasuritë neto për tu blerë	ZAR42

Aksionarët e CAB do të paguhën në para në lartësi prej ZAR42,000,000 nga kompania ABC më 30 shtator 2009. ABC planifikon ta financoj këtë blerje nëpërmjet marrjes së një kredie në euro. Përgjatë vitit të ardhshëm ABC do të paguaj vetëm interesin e kësaj kredie.

Norma e projektuar spot më 30 shtator 2009 është 10 ZAR = €1. Pritet që euro të fuqizohet ndaj valutës ZAR në vitet e ardhshme. Norma e projektuar e këmbimit për qëllime të transaksioneve më 30 shtator 2010 është 12 ZAR = €1.

CAB nuk ka ndonjë investim tjetër në valutë të huaj.

Kërkesa:

- (a) Shpjegoni shkurtimisht termin 'Rreziku i Përkthimit të Valutës së Huaj'. (8 pikë)
- (b) Shpjegoni ndikimin eventual të rrezikut të përkthimit të valutës së huaj për bilancin e gjendjes së ABC më 30 shtator 2010. (10 pikë)
- (c) Shpjegoni dhe rekomandoni ABC-së veprimet të cilat mund ti ndërmer ajo për të eliminuar rrezikun potencial të shpjeguar në pikën (a). (7 pikë)
- (Totali = 25 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

(a) Rreziku i përkthimit të valutës së huaj

Në rastet kur kompania investon në ekonomitë e vendeve të huaja të cilat përdorin valutë tjetër nga valuta vendore e kompanisë, atëherë kompania mëmë duhet të përfshijë investimet e tilla në bilancin e saj të gjendjes. Për qëllime të përfshirjes së këtij investimi, kompania do të duhej të konvertoj vlerën e investimit të huaj në valutën vendore sipas normës së këmbimit në datën e bilancit të gjendjes. Në rastet kur investimet e tilla mbahen për më shumë se një vit, ekziston rreziku që vlera e investimit (e cila duhet të përfshihet në bilanc të gjendjes) mund të pësoj rënie në vlerë nëse valuta e huaj është dobësuar në raport me valutën vendore. Kjo njihet si rreziku i përkthimit të valutës së huaj.

(b) Efekti i parashikuar i rrezikut të përkthimit në bilancin e gjendjes të ABC-së

Për të blerë asetet neto të CAB-së në lartësi prej ZAR 42m, ABC duhet të merr një kredi në EURO në lartësi prej €4.2m sipas normës së propozuar spot të datës 30.09.2009 që është ZAR10 = €1. Kjo kredi do të bashkërendohet me neto asetet e CAB që do të vlejnjë €4.2m kur të konsolidohet në bilancin e gjendjes së ABC-së.

Pritet që valuta ZAR do të dobësohet në raport me EURO gjatë vitit që përfundon më 30.09.2010, duke marrë për bazë që pasuritë neto të ABC-së janë pasuri në ZAR, ato do të vlejnjë 3.5m në datën e konsolidimit në bilancin e gjendjes së ABC-së. Këto pasuri neto do të krahasohen me kredinë në vlerë prej €4.2m që është përdorur për ti blerë këto pasuri neto. Prandaj, gjatë vitit bilanci i gjendjes së ABC-së do të pësoj një rënie në vlerë prej €0.7m drejtpërdrejtë si rezultat i ndryshimit të normës së këmbimit e cila ka ndodhur gjatë vitit. Kjo tabelë i përfshinë detajet:

CAB Blerja e financuar me kredi në € Bilanci i Gjendjes i projektuar për qëllime të konsolidimit	Asetet Neto Të blera 30/09/2009	Bilanci i Gjendjes më 30/09/2009 (ZAR10=€1)	Bilanci i Gjendjes më 30/09/2010 (ZAR12=€1)
	ZAR M	€ M	€ M
Asetet neto për tu konsoliduar	42	4.2	3.5
	€M	€ M	€ M
Kredia në EURO	4.2	4.2	4.2
			€M
Humbja në bilancin e gjendjes më 30.09.2010			-0.7

(c) Menaxhimi i Rrezikut të Përkthimit Valutor

Mënyra më efektive për eliminimin e rrezikut të tillë është që të bëhet bashkërendimi i investimit të huaj me një detyrim i deonominuar në valutën e njëjtë të huaj. Në këtë rast, për ABC-në do të nënkuptonte marrjen e kredisë në ZAR. Meqenëse edhe kjo kredi do të kishte nevojë të përkthejnjë në bilancin e gjendjes të ABC-së, kjo vlerë do të rritjen apo zbritjen me fuqizimin apo dobësimin e valutës ZAR. Efekti në bilanc të gjendjes do të jetë zero, pasi që efekti në asete do të kundërbalancohet (netohet) me efektin në detyrime. Ky ilustrim e shpjegon këtë rast:

CAB Blerja e financuar me kredi në € Bilanci i Gjendjes i projektuar për qëllime të konsolidimit	Asetet Neto Të blera 30/09/2009	Bilanci i Gjendjes më 30/09/2009 (ZAR10=€1)	Bilanci i Gjendjes më 30/09/2010 (ZAR12=€1)
	ZAR M	€ M	€ M
Asetet neto për tu konsoliduar	42	4.2	3.5
Kredia në ZAR	ZAR M 42	€ M 4.2	€ M 3.5
Humbja në bilancin e gjendjes më 30.09.2010			€M €0.0